


UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E AUTOINJEKTORIT TË EPIPEN-IT

Të nderuar!


Autoinjektorët e EpiPen-it janë menduar për përdorim të menjëhershëm në pacientët me rrezik të shtuar të njohur për anafilaksi, duke përfshirë individët që kanë përjetuar anafilaksi.

Vendoseni fëmijën:


- në një pozicion të shtrirë, nëse është i zbehtë, i dobët, i hutuar...
- anash nëse vjell, ose
- në pozicion ulur nëse ka vështirësi në frymëmarrje.




1. Mbajeni autoinjektorin e EpiPen-it me dorën dominante, me gishtin e madh më afër kapakut të kaltër të sigurisë. Me dorën tjetër, hiqni kapakun e kaltër të sigurisë.



2. Mbajeni autoinjektorin e EpiPen-it afërsisht 10 cm nga pjesa e jashtme e kofshës. Maja portokalli duhet të jetë përballë pjesës së jashtme të kofshës.



3. Shtypni EpiPen-in fort në pjesën e jashtme të kofshës në mënyrë që të jetë në një **kënd të drejtë** (90°). Ju do të dëgjoni një "klik" kur pajisja të aktivizohet. Mbajeni autoinjektorin e EpiPen-it në vend për 5 sekonda.



4. Hiqni autoinjektorin e EpiPen-it nga vendi i injektimit dhe masazhoni butësisht vendin për të përshpejtuar përthithjen e barit.

5. **Telefononi në numrin 112, kërkoni një ambulancë dhe njoftoni për anaflaksinë.**

6. Nëse simptomat nuk përmirësohen, pas 5-15 minutash mund të përdoret një tjetër autoinjektor EpiPen-i.

Reperti i Pediatriisë
Kodi i katalogut: POo-07
Tetor 2023, versioni 1